

---

**JETA SHKENCORE**

---

**KONFERENCE SHKENCORE:  
“SHQIPËRIA DHE NATO”**

Më 16 qershor 2008 Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Instituti i Historisë organizuan konferencën shkencore “Shqipëria dhe NATO”. Konferenca u hap nga Dr. Ardian Marashi – drejtori i QSA, dhe u përshëndet nga z. Genc Pollo- ministër i Arsimit dhe i Shkencës. Në konferencë u mbajtën 6 kumtesa, të cilat trajtuan probleme të ndryshme që kishin të bënin me problemet e sigurisë së shtetit shqiptar gjatë shekullit të 20 dhe aspiratat perëndimore të shqiptarëve; me raportet e Shqipërisë me NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë Luftës së Ftohtë; me përfshirjen dhe largimin e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, me përpjekjet e SHBA për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë dhe trajtimin e situatave të pasigurta të Shqipërisë pas daljes nga Traktati i Varshavës ; me angazhimin ushtarak të NATO-s në Kosovë dhe Jugosllavi dhe me integrimin e natyrshëm të Shqipërisë në Organizatën e Atlantikut të Veriut.

Prof. Dr. Beqir Meta mbajti kumtesën: “NATO dhe Shqipëria, episode të Luftës së Ftohtë”. NATO u krijua në momentet e para dramatike të Luftës së Ftohtë, si një instrument politiko-ushtarak i demokracive perëndimore për të mbrojtur ato dhe njerëzimin nga ekspansioni komunist. Raportet e Shqipërisë komuniste me NATO-n ishin të këqija sepse Shqipëria komuniste ishte e rreshtuar dhe integruar në bllokun e vendeve komuniste të udhëhequra nga Bashkimi Sovjetik dhe bënte lojën e këtij grupimi. Por në kumtesë nënvizohet ideja se NATO ju përmbajt politikës tradicionale të SHBA për ruajtjen e shtetit shqiptar, të pavarësisë dhe tërësisë territoriale të tij, duke frenuar në jo pak raste lakmitë e fqinjëve të Shqipërisë për copëtimin e saj, ndonëse Shqipëria në disa raste u përfshi në aksionet konfrontuese Lindje-Perëndim, si konflikti civil në Greqi në vitet 1947-1949 etj.

Prof. Dr. Muharrem Dezhgiu përmes kumtesës së tij për “Dilemat e sigurisë dhe aspirata perëndimore e shqiptarëve” trajtoi dilemat e shtetit shqiptar dhe botës shqiptare pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, të cilat penguan stabilitetin dhe sigurinë e vendit, prosperitetin e tij dhe po kështu afrimin dhe integrimin e tij në strukturat perëndimore. Autori

theksoi disa faktorë frenues të jashtëm e të brendshëm si, ndërhyrjet e fuqive të mëdha dhe lakmive territoriale ndaj Shqipërisë, të fqinjëve më të fuqishëm të saj, pozitën gjeo-strategjike të vendit, por edhe faktorë të tillë të brendshëm si mungesën e ndërgjegjësimit kombëtar të disa shtresave dhe individëve brenda vendit, të cilët prireshin drejt shteteve e fuqive jo miqësore me Shqipërinë.

Prof. Dr. Ana Lalaj me kumtesën “Shqipëria nga Traktatit i Varshavës në NATO”, analizoi rrugën e Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë drejt NATO-s, integrimin e saj në Traktatin e Varshavës dhe shfrytëzimin e këtij të fundit për të riformtuar autoritetin e udhëheqjes staliniste të Enver Hoxhës në Shqipëri. Ndërtimi i bazës ushtarake të Vlorës e shndërroi Shqipërinë në avanpostin ushtarak të bllokut sovjetik dhe në “shtat të nxehtë” të Luftës së Ftohtë. Shqipëria u orientua nga nacionalizmi stalinist i Enver Hoxhës, i cili në emër të mbrojtjes së integritetit të vendit, mbylli kufijtë dhe ushquu psikozën e rrezikut permanent të jashtëm. Autorja përmend disa dokumente të rëndësishme për qëndrimin e SHBA ndaj konfliktit shqiptaro-sovjetik në vitet 1960-1961. Integrimin e Shqipërisë në NATO ajo e konsideron si një proces që Shqipëria jo vetëm përfiton siguri por edhe e prodhon atë.

Në kumtesën e mbajtur nga Prof. Dr. Valentina Duka “Integrimi në NATO si sfidë e Shqipërisë në tranzicion”, u theksua se Shqipëria u orientua dhe fokusua shpejt në objektivin e saj drejt NATO-s, duke u përpjekur të përmbushë detyrimet e veta për tu bërë anëtare e saj, në rrethanat e vështira të tranzicionit të zgjatur të vendit. Ky ishte dhe mbeti një objektiv konstant për Shqipërinë. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO përmbushi një ide të kahershme të shqiptarëve për tu orientuar drejt perëndimit dhe vlerave më të mira të tij.

Prof. Dr. Marenglen Verli në kumtimin e tij “Çështja e Kosovës dhe NATO” trajtoi dhe argumentoi se aksioni i NATO-s në Kosovë dhe në Serbi në vitin 1999, ishte i motivuar për arsye të forta historike, morale dhe juridike. Autori analizoi tetë arsyet se pse Kosova e meritonte të ishte shtet i pavarur, i lirë dhe sovran në bashkësinë e shteteve të Evropës së Bashkuar. Kumtesa analizoi dhe nënvizoi fazat dhe rrugën e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë dhe qëndrimin tradicionalist nationalist të Serbisë dhe liderëve të saj në fundshekullin e kaluar. Aksioni i NATO-s në Kosovë tregoi për rivlerësimin e pozitës strategjike të shqiptarëve në rajonin tonë dhe për mungesën e paragjykimëve të karakterit etnik dhe fetar.

Prof. As. Dr. Hamit Kaba me kumtimin “Politika e SHBA ndaj Shqipërisë në vitet 70 dhe reflektimi i saj në NATO”, u fokusua në ndryshimet që ndodhën në politikën e jashtme të SHBA në fund të viteve 60 dhe në fillim të viteve 70, të cilët shënuan fundin e politikës së “Përbajtjes” dhe zëvendësimin e saj me “Realpolitikën”, arkitekt i së cilës u bë ish-presidenti Nikson. “Realpolitika” krijoi premisa për të ndërtuar raporte të tjera me vendet ish-komuniste të Evropës, për ti dhënë fund luftës në Vietnam, për të zgjidhur krizën e Berlinit Perëndimor, mbajtjen e Konferencës së Helsinkit etj. Autori prezanton dhe analizon propozimet amerikane për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, duke shfrytëzuar e kombinuar rrugët diplomatike me forma të tjera të karakterit kulturor, shkencor, sportiv, diasporën shqiptare në SHBA etj. Por udhëheqja komuniste e Shqipërisë i refuzoi në mënyrë të vazhdueshme propozimet amerikane, duke humbur edhe një shans tjetër, në radhën e shanseve të humbura gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

**H. KABA**

**PJESËMARRJA E STUDIUESVE TË INSTITUTIT  
TË HISTORISË-TIRANË NË VEPRIMTARI  
TË NDRYSHME SHKENCORE**

Në vitin 2008 veprimtari të ndryshme të organizuara nga institucione shkencore brenda e jashtë vendit patën bashkëpunimin e pjesëmarrjen e studiuesve të Institutit të Historisë.

Më 21 janar 2008 Marenglen Verli, në cilësinë e Drejtorit të Institutit të Historisë, mbajti fjalën e rastit në veprimtarinë e organizuar nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, në Akademinë e Shkencave, për promovimin e librit të Prof. Dr. Hysni Myzyrit (pas vdekjes): “Arsimi Kombëtar Shqiptar 1908-1912”, të publikuar në gjuhën angleze me titull “National Education during Albanien Renaissance”. Gjatë vitit 2008, ai ka marrë pjesë me kumtesën: “Çështja shqiptare, politikat e fqinjëve dhe gjeopolitikat ballkanike gjatë shek. XX”, edhe në simpoziumin shkencor “Kumanova për flamur – nga NDSH të UÇK”, e cila u përfshi në vëllimin me të njëjtin titull, të promovuar më 28.12.2008 në Kumanovë. Kurse më 25 maj 2008 mori pjesë në simpoziumin shkencor të organizuar në Frashër të Përmetit, kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me kumtesën me titull: “Qëndrimi dhe pikëpamjet e diplomacisë austro-hungareze ndaj Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”.

Marenglen Verli, Ferit Duka dhe Luan Malltezi ishin studiuesit e Institutit që u paraqitën me kumtesa në Konferencën shkencore të organizuar më 2 mars 2008 nga Universiteti Mbretëror Iliria-Prishtinë, të titulluar: “Besëlidhja e Lezhës dhe roli i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut në historinë shqiptare”. Titujt e kumtesave ishin përkatësisht: “Skënderbeu, simbol i luftës për liri e progres shoqëror”, “Skënderbeu në kujtesën e shqiptarëve”, “Kuvendi i Lezhës dhe mesazhet e tij”.

Një veprimtari shkencore jashtë vendit në të cilën morën pjesë dy studiues të Institutit të Historisë ka qenë Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Evropa Lindore dhe Qendrore në Luftën e Ftohtë, 1945-1989”, mbajtur në Poloni më 16-18 tetor 2008. Hamit Kaba mbajti me këtë rast kumtesën “Konflikti shqiptaro-sovjetik dhe shfrytëzimi i tij nga Perëndimi”, kurse Ana Lalaj, kumtesën: “Konflikti me sovjetikët dhe aleati i fundit i Shqipërisë komuniste”.

Më 24-15 nëntor 2008 në Konferencën Shkencore të organizuar nga Instituti i Historisë – Prishtinë, me rastin e 40-vjetorit të demonstratave të vitit 1968, morën pjesë me kumtesa: Ana Lalaj,

“Detantë 1968: Një brez në revoltë” dhe Marenglen Verli, “Viti 1968, moment kulmor i prezantimit të aspiratave të shqiptarëve në historinë e një shekulli”.

Një veprimtari tjetër e rëndësishme ishte Seminari XXII Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, i mbajtur në Prishtinë më 18-29 shtator 2008, me organizator Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin e Tiranës, përkatësisht Fakultetin e Filologjisë-Prishtinë dhe Fakultetin Histori-Filologji-Tiranë. Në këtë konferencë nga Instituti ynë mori pjesë Marenglen Verli me kumtesën: “Nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit te pavarësia e Kosovës”.

Në 1-3 shtator 2008, Hamit Kaba, Sonila Boçi, Ana Lalaj dhe Ledia Dushku u paraqitën me kumtesa në Konferencën Ndërkombëtare të organizuar në Tiranë nga Alb-Shkenca, përkatësisht me temat: “Konflikti shqiptaro-sovjetik(1961) dhe sovjeto-jugosllav (1948) në sytë e Perëndimit”, “Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 dhe çështja e legjitimitetit të regjimit komunist në Shqipëri”, “Detanta e parë” dhe Shqipëria 1953-1960”, “Filozofia e politikës greke ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”.

Muharrem Dezhgiu ka marrë pjesën në sesionin shkencor me rastin e 80-vjetorit të Gardës së Shtetit Shqiptar organizuar në Tiranë më 28 qershor 2008 me kumtesën “Nga Garda Pretoriane e Skënderbeut te Garda Mbretërore e Ahmet Zogut”. Gjithashtu ka marrë pjesë me kumtesën “Shqiptarët dhe dilemat e pavarësisë së tyre deri në Luftën e Dytë Botërore” në Konferencën Shkencore të Studimeve Albanologjike, që u organizua në Ohër më 23 shtator 2008. Këtë kumtesë e ka mbajtur edhe në konferencën shkencore në Ferizaj (Sojevë) të Kosovës më 26 korrik 2008. Po kështu ka mbajtur edhe një kumtesë në sesionin shkencor organizuar nga Bashkia Përmet më datë 3 tetor 2008 “Mithat Frashëri – nacionalist i shquar”.

Më 19 dhjetor 2008, Qendra e Studimeve Albanologjike, pjesë e së cilës është Instituti i Historisë, organizoi Simpoziumin shkencor Ndërkombëtar: “Vepra themelore në Albanologji” shoqëruar me ndarjen e 3 çmimeve për veprat më të mira për autorët vendas, autorët e huaj dhe veprat me bashkautorë. Nga Instituti ynë konkurruan për çmime: Beqir Meta me monografinë “Shqipëria dhe Greqia, paqja e vështirë (1949-1990), Muharrem Dezhgiu me monografinë “Shqipëria nën pushtimin italian 1939-1943” dhe Dritan Egro me “Historia dhe ideologjia: një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare (gjysma e dytë e shek. XIX deri sot), për të cilat referuan respektivisht

Hamit Kaba, Beqir Meta dhe Ferit Duka. Gjithashtu referuan Luan Malltezi për “Dilemat e Arbrit” të Pëllumb Xhufit dhe Marenglen Verli për “Kosova - një histori e shkurtër” e autorit britanik Noel Malkolm, i cili mori edhe çmimin e vënë nga QSA për autorët e huaj.

Gjatë vitit 2008 studiuesit e Institutit të Historisë kanë kumtuar edhe në disa veprimtari shkencore të organizuara nga vetë Instituti në kuadër të QSA. Informimi për këtë veprimtari jepet i plotë në shkrime të veçanta në faqet e këtij numri të revistës.

\* \* \*

Studiuesit e Institutit të Historisë gjatë vitit 2008 u paraqitën si autorë, bashkautorë, redaktorë shkencorë etj., edhe në disa botime që u publikuan këtë vit.

Me redaktim të Xhelal Gjeçovit, dhe autorë Xhelal Gjeçovin, Beqir Metën, Dilaver Sadikajn (pas vdekjes), Demir Dymishin, Ana Lalajn dhe Marenglen Verlin (pjesë e grupit prej 16 autorësh) u botua “Historia e Popullit Shqiptar (1939-1990)”, vëllimi IV. Gjatë vitit 2008 doli nga shtypi edhe vëllimi “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878)”, vëllimi I, përgatitur e redaktuar nga Beqir Meta, Ferit Duka, Marenglen Verli. Këtë vit u botua edhe vëllimi me dokumentet e mbledhura nga Lef Nosi për periudhën e viteve 1912-1918, i titulluar “Dokumente historike (1912-1918)”. Vëllimi u përgatit dhe u redaktua nga Marenglen Verli dhe Ferit Duka. Me redaktim të Marenglen Verlit u botua edhe vëllimi me kumtesat e mbajtura në Konferencën Shkencore kushtuar 95-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, titulluar “Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek.XX”. Me paraqitjen, redaktimin etj., të Marenglen Verlit, gjatë vitit 2008 doli nga shtypi në dy vëllime edhe “Shqipëria e viteve 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës”, botim ky në gjininë e kujtimeve.

Për disa monografi, përmbledhje etj., ndërkohë vijoi puna, e cila pritet të finalizohet me botime gjatë vitit 2009.

**M. VERLI**